



P Z A P
I P Ž P

REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS - SUDSKI SAVET KOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL
PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA
IZBORNİ PANEL ZA ŽALBE I PREDSTAVKE - ELECTION COMPLAINTS AND APPEALS PANEL

Anr.263/2025

PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA (PZAP), i përbërë nga gjyqtaret: Skender Çoçaj kryesues, Kymete Kicaj dhe Arsim Hamzaj anëtarë, duke vendosur përkitazi me ankesën e Fileit L.L.C, me seli në Pejë, ka paraqitur ankesë kundër Subjektit Politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), me seli në Prishtinë, për shkak të shkeljes së Kodit të Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët, gjatë fushatës zgjedhore për Kuvendin e Republikës së Kosovës, që do të mbahen më datë 09 Shkurt 2025, në seancën e panelit të mbajtur më datë 01.02.2025, merr këtë:

V E N D I M

Refuzohet e pabazuar ankesa Anr.263/2025 e datës 30.01.2025, e parashtruar nga Fileit L.L.C, me seli në Pejë, paraqitur kundër Subjektit Politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), me seli në Prishtinë, për shkak të shkeljes së Kodit të Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët, gjatë fushatës zgjedhore, për Zgjedhjet e Përgjithshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës që do të mbahen më datë 09.02.2025.

A r s y e t i m

Me datë 30.01.2025 PZAP-i, ka pranuar një ankesë nga Fileit L.L.C, me seli në Pejë, me të cilën pretendon se më datë 26 janar 2025, rrëth orës 21:00, në rrjetin social facebook, kandidati për kryeministër, nga radhët e subjektit politik LDK, z.Lumir Abdixhiku, ka postuar shkrimin e titulluar “Pejë, Lule e Dukagjinit”, ku në kuadër të këtij shkrimi, ndër të tjera deklaron se “*Do ta shndërrojmë Dukagjinin në perlë të turizmit malor me investim 50 milionësh për ndërtimin e Qendrës Borea brenda mandatit*”. Më tutje parashtruesi i ankesës ka theksuar se kandidati për kryeministër nga radhët e LDK-së e paraqet ndërtimin e projektit “Borea” si investim publik, duke deklaruar në investime nga shteti-publike, ky deklarim paraqet shkelje të rëndë të nenit 34, të LZP-së, kjo sepse sipas parashtruesit të ankesës siç dihet, ndërtimi i “Qendrës Turistike Borea” nuk është investim publik i cili mund të bëhet nga Qeveria e Republikës së Kosovës, pavarësisht subjektit se kush mund të udhëheqë me të, por e njëjtë është projekt investiv privat i cili pritet të realizohet nga Konzorciumi “Leitner SPV&Filav SA”, me përfaqësues Fileit L.L.C. Po ashtu në ankesë është theksuar veprimet e mësipërme

paraqesin veprime në dëm të pasurisë, andaj të njëjtat duhet të sanksionohen nga PZAP, gjë të cilën e kërkojmë përmes kësaj ankesë.

Si dëshmi për pretendimet e tij, paraqitësi i ankesës, ka bashkangjitur një fotografi, nga postimi i datës 26 janar 2025, rrëth orës 21:00, në rrjetin social facebook.

Më datë 30.01.2025, PZAP-i, e njoftoi Subjektit Politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), për ankesën e paraqitur kundër tyre, duke i dërguar kërkesë për përgjigje.

Në përgjigje në ankesë të paraqitur me datë 31.01.2025, Subjektit Politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), theksin, pretendimi se subjekti politik LDK, respektivisht kandidati për kryeministër z.Lumir Abdixhiku ka shkelur nenin 34 të LZP-së, nuk qëndron fare dhe nuk gjen asnjë mbështetje ligjore në pretendimin ankimor. Pretendimi ankimor është më shumë një paragjykim mbi shkrimin e cekur më lartë sesa një provë konkrete, nuk përfaqëson e as nuk përbënë shkelje në asnjë rrëthanë. Më tutje parashtuesi i ankesës ka theksuar se në asnjë rresht të statusit të tij, kryetari i LDK-së z.Lumri Abdixhiku nuk ka specifikuar ose cilësuar apo paraqit çështjen në fjalë si investim publik, sepse edhe po të thuhej një gjë e tillë ende nuk është rrëthanë e ndodhur as juridikisht e as politikisht, që kemi një Qeveri të re dhe se ajo qeveri po premton ose zhvillon punë apo investime që potencialisht nuk mund të jenë të saja apo të ngashme dhe përmes përgjigjes në ankesë ka kërkuar nga PZAP që ta refuzojë si të pabazuar ankesën.

Paneli, pasi që shqyrtoj të gjitha shkresat e lëndës në kuptim të nenit 117 par. 3 të LZP-së, konstatoi se:

Ankesë është e pabazuar

Paneli pas shikimit të shkresave të lëndës dhe përgjigjes në ankesë të paraqitur nga subjekti politik LDK, vlerësoj se pretendimet e Fileit L.L.C, me seli në Pejë, janë të pa qëndrueshme pasi që premtimet e dhëna gjatë fushatës zgjedhore për zhvillim nuk përbëjnë shkelje, prandaj edhe pretendimet ankimore si të tillë i refuzoj, prandaj lidhur me këtë çështje PZAP-i, ankesë e parashtuar e konsideron si të përgjithësuar dhe të pa bazuar në fakte, dëshmi të qarta dhe bindëse konform dispozitës ligjore të nenit 117 paragrafi 3 i Ligjit nr. 08/L-228 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, edhe pse barra e të provuarit bie mbi parashtuesin e ankesës.

Andaj duke u mbështetur në nenin 117.3 të LZP-së ku përcaktohet se: “*Vendosja për ankesat nga PZAP-i mbështetet në dëshmi të qarta dhe bindëse*”, Paneli vlerësoj se pretendimet e tillë janë të pa qëndrueshme dhe si të tillë i refuzoj, përfaktin se nga veprimet e përshkruara në ankesë dhe nga mos ofrimi i asnjë prove apo dëshmie parashtuesi i ankesës nuk ka arritur që të vërtetoj se ka pasur ndonjë parregullsi, pasi që ankesa e parashtuesit ka qenë sipërfaqësore dhe jo e konkretizuar, dhe si të tillë të njëjtën e refuzoi si të pabazuar.

Paneli në kuptim të nenit 117.3 dhe nenit 118 par.1 të LZP-së, Paneli vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Anr.263/2025 më datë 01.02.2025



Këshilla Juridike: Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas nenit 118 paragrafi 4 të LZP-së, në Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda dyzet e tetë (48) orëve nga momenti i marrjes-pranimit të këtij vendimi.